

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët Kujtim Pasuli – kryetar i kolegjit, Nenad Laziq dhe Makifete Saliuka-anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.H. nga Prishtina, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit av. Z.I., nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “NN”, me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson me autorizim K.P., jur. e dipl. për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit 21.513,00€, duke vendosur sipas ankesës të paditurës, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2531/2008 të datës 06.12.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur me 18.01.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.PRANOHET ankesa e paditurës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2531/2008 të datës 06.12.2013, **NDRYSHOHET** përkitazi me dëmin jo material për dhimbje fizike të pësuar dhe gjykohet shuma prej 2.900 €, frikën e pësuar dhe gjykohet shuma prej 2.700 €, për zvogëlim të aktivitetit jetësor dhe gjykohet shuma prej 4.600 €, dhe në emër të shëmtimit dhe gjykohet shuma prej 2.350 €, ndërsa në emër të dëmit material për kujdes dhe ndihmë personit të tretë gjykohet shuma prej 110 €, dhe ushqim të përforcuar gjykohet në shumë prej 130 €, për 70% të përgjegjësisë së të paditurës.

II. PRANOHET ankesa e të paditurës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2531/2008 të datës 06.12.2013, **NDRYSHOHET** përkitazi me lartësinë e kamatës së gjykuar, ashtu që tani gjykohet me kamatë për të gjitha shumat e gjykuara nga data 06.12.2013, kur është marrë aktgjykimi, e në lartësi të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e afatizuara për një vit pa destinim të caktuar deri në pagesën definitive.

III. Në pjesën tjetër ankesa e paditurës i paraqitur kundër aktgjykimit në fjalë refuzohet si e pa bazuar.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e goditur nën I të dispozitivit është aprovuar pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses dhe është detyruar e paditura që paditëses në emër të dëmit material dhe jo material nga baza e auto përgjegjësisë për 70%, të përgjegjësisë t'ia paguaj shumat si vijon:

- Për dhimbje fizike shumë prej.....3.800,00€
- Për frikë shumë prej.....3.800,00€,
- Për zvogëlim të aktivitetit jetësor shumë prej ..7.600 €
- Për shëmtim trupor shumë prej 3.800 € dhe
- Në emër të dëmit material për kujdesin dhe ndihmën e personit të tret shumë prej 140€ dhe në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej 163 €. Nën II të dispozitivit është detyruar e paditura të paguaj shumat e cekura si në pikën I të dispozitivit ashtu që shuma e tërësishme arrin vlerën prej 19.303 €, kamatën

vjetore prej 3.5%, duke filluar nga data 06.12.2013, për pjesën e gjykuar të kompensimit si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 663,60 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit. Nën III të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar pjesa e kërkesëpadisë si kompensimi për dhimbje fizike në shumë prej 400 €, për frikë në shumë prej 400 €, për shëmtim trupor në shumë prej 400 €, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 800 €, për ushqim të përforcuar shumë prej 210 €, dhe për shpenzime të procedurës kontestimore në lartësi prej 284,40 €.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë e paditura për shkak të:

-shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe
-Konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, t'ia miratoj ankesën dhe aktgjykimin e atakuar, ta prish dhe lëndën ta kthej gjykatës të shkallës së parë në rigjykim ose të vërtetohet pjesërisht dhe ato për shumë reale në lartësi prej 6.860 €, ndërsa pjesën tjetër shumë mbi këtë lartësi ta refuzoj si të pabazuar.

Përgjigje në ankesë nuk është parashtruar.

Duke vlerësuar aktgjykimin e goditur në pajtim me nenin 194 të LPK, në kuadër të kufijve të pretendimeve ankimore dhe duke pasur kujdes sipas detyrës zyrtare për shkeljet thelbësore të dispozitave të LPK-së të parapara me nenin 182 par.1 e 2 dhe për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, gjeti se:

Ankesa e paditurës është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësja ka parashtruar padi për kompensimin e dëmit material dhe jo material për shkak të aksidentit të pësuar në komunikacion me dt. 17.12.2007 dhe me parashtrësën e dt.05.11.2013, ka precizuar kërkesëpadinë duke theksuar se kërkon dëmin jo material për dhimbje fizike në shumë prej 4.200 €, e zbritur për 30% në emër të lëshimeve të paditëses, për frikë shumë prej 4.200€, e zbritur për 30% në emër të lëshimeve të paditëses, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 8.400 €, e zbritur për 30% në emër të lëshimeve të paditëses, për shëmtim trupor shumë prej 4.200 €, e zbritur për 30% në emër të lëshimeve të paditëses, dhe për dëmin material për ndihmën dhe kujdesin e huaj shumë prej 140 €, e zbritur për 30%, në emër të lëshimeve të paditëses dhe për ushqim të përforcuar shumë prej 210€, e zbritur për 30% në emër të lëshimeve të paditëses dhe për shpenzimet materiale gjatë kohës së shërimit në shumë prej 163 €, e zbritur për 30% në emër të lëshimeve të paditëses, të gjitha këto me kamatë siç e paguajnë bankat për mjetet pa destinacion të caktuar të afatizuara mbi 12 muaj, duke filluar nga data e gjykimin e gjer në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit dhe vlerësimit të provave ka marr aktgjykimin të përshkruar më së afërmi si më lart, duke gjetur se sipas ekspertizës së komunikacionit ekziston përgjegjësia e ndarë ashtu që përfundon se 70% fajësia është te drejtuesi i automjetit i siguruar te e paditura, ndërsa paditësja si këmbësor mban përgjegjësi, përkatësisht është fajtorë për 30%, dhe lidhur me këtë ka aplikuar dispozitën e nenit 178 alineja 2 të LMD-së. Sa i përket lëndimeve dhe lartësisë së shumave të gjykuara gjykata e shkallës së parë ka pasur parasysh mendimi e ekspertëve mjeko-ligjor, ortopedit-traumatolog, ekspertin e mjekësisë ligjore dhe psikiatër. Vendimin e vetë Gjykata e shkallës së parë e mbështetë në nenet 154,158,178 alineja 2 ,186,195 alineja 1 dhe nenit 200 alineja 1 dhe 2 të LMD-së. Sa i përket kamatës ka vendosur në kuptim të

neneve 186 dhe 277 të LMD-së, ndërsa vendimin mbishpenzimet e procedurës të njëjtën e bazon në nenin 452.2 të LPK-së.

Pran një gjendje të këtillë të çështjes Gjykata e Apelit të Kosovës në Prishtinë, vlerëson se përcaktimi i kompensimit për dëmin jo material paraqet zbatim të së drejtës materiale, atëherë kjo gjykatë gjen se shumata e gjykuara për paditësen, në emër të dhimbjeve fizike, për frik, për zvogëlim të aktivitetit jetësor, shëmtim, kujdesit dhe ndihma e personit të tretë dhe ushqim të përforcuar janë marr me zbatim të gabuar të së drejtës materiale ngase nuk kanë qenë adekuate dhe në përputhje me natyrën e shpërblimit të dëmit jo material dhe material, duke marr parasysh rëndësinë e shkallës së mirës dhe qëllimit që shërben ky kompensim-shpërblim siç është paraparë me nenin 200 par. 1 e 2 të LMD.

Kjo gjykatë duke pranuar pjesërisht ankesën e paditurës e ndryshoj aktgjykimin e gjykatës të shkallës së parë ashtu që gjykoj shumata si në I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh moshën e paditëses në kohën kur ka pësuar fatkeqësinë, natyrën e lëndimeve të pësuaras si dhe qëllimin e shpërblimit të dëmit jo material dhe se tani kjo gjykatë konsideron se me ndihmën e shumave të caktuara-gjykuara, paditësja mund të përjetojë një satisfaksion të konsiderueshëm, e duke marrë parasysh përgjegjësinë e ndarë 70% me 30%.

Gjykata e Apelit e Kosovës, ka gjetur se vendimi për kamatën është marr me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, përkatësisht është zbatuar në mënyrë jo të drejtë dispozita e nenit 277 të LMD, ngase kjo kamatë nuk është caktuar në përputhshmëri me këtë dispozitë ligjore. Andaj, duke u nisur nga fakti se lidhur me kamatën e aprovuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është marr me zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe për këtë arsye i njëjti aktgjykim në këtë pjesë u ndryshuar.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate në pjesën refuzuese të aktgjykimit e njëjta nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në të cilat kjo gjykatë shikon sipas detyrës zyrtare, e as në ato në të cilat thirret ankesa dhe njëherit gjendja faktike drejtë është vërtetuar, me që rast edhe drejtë është zbatuar e drejta materiale. Për vendimin e vet në këtë pjesë gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftuara lidhur me të gjitha faktet vendimtare dhe një mendim të tillë të gjykatës të shkallës së parë në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë.

Nga arsyet e cekura ankesa tregohet pjesërisht e bazuar, prandaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 195. par. 1 pika d) dhe 195 par.1 pika e) të LPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.2082/2014 me dt. 18.01.2017

Kryetari i kolegjit – gjyqtari
Kujtim Pasuli

PROCESVERBAL MBI KËSHILLIMIN DHE VOTIMIN

I përpiluar pranë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në seancën kolegjit të mbajtur me datë 18.01.2017

TË PRANISHËM JANË:

Kryetari i kolegjit-gjyqtari Kujtim Pasuli
Anëtarët e kolegjit-gjyqtarët Makifete Saliuka e Gani Avdiu

Duke vendosur sipas ankesës të paditurës, të ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2531/2008 të datës 06.12.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur me 18.01.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.PRANOHET ankesa e paditurës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2531/2008 të datës 06.12.2013, **NDRYSHOHET** përkitazi me dëmin jo material për dhimbje fizike të pësuar dhe gjykohet shuma prej 2.900 €, frikën e pësuar dhe gjykohet shuma prej 2.700 €, për zvogëlim të aktivitetit jetësor dhe gjykohet shuma prej 4.600 €, dhe në emër të shëmtimit dhe gjykohet shuma prej 2.350 €, ndërsa në emër të dëmit material për kujdes dhe ndihmë personit të tretë gjykohet shuma prej 110 €, dhe ushqim të përforcuar gjykohet në shumë prej 130 €, për 70% të përgjegjësisë së të paditurës.

II. PRANOHET ankesa e të paditurës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2531/2008 të datës 06.12.2013 , **NDRYSHOHET** përkitazi me lartësinë e kamatës së gjykuar, ashtu që tani gjykohet me kamatë për të gjitha shumat e gjykuara nga data 06.12.2013, kur është marrë aktgjykimi, e në lartësi të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e afatizuara për një vit pa destinim të caktuar deri në pagesën definitive.

III. Në pjesën tjetër ankesa e paditurës i paraqitur kundër aktgjyqimit në fjalë refuzohet si e pa bazuar.

Anëtarët e kolegjit

Kryetari i kolegjit

1. Nenad Laziq

2. Makifete Saliuka

Kujtim Pasuli